



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 28.1.2025

Nr: 42

Ora: 10:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E RAPORTIT MBI VEPRIMTARITË PUBLIKE PËR PERIUdhËN 19  
JANAR – 25 JANAR 2025**

Sot, më datë 28.01.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

**OBJEKT:** Shqyrtimi i raportit mbi veprimtaritë me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**V E N D O S:**

1. Miratimin e raportit të gjetjeve mbi veprimtaritë publike për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
3. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Roskovec.
4. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
5. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Zyrës Vendore Arsimore Elbasan.
6. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Sarandë.
7. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Ministrisë së Financave.

Data: 28.1.2025 Nr: 42  
Ora: 10:00



“Për shqyrtimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

8. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.
9. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Korporatës së Investimeve Shqiptare.
10. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
11. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bankës së Shqipërisë.
12. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Elbasan.
13. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor.
14. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Mat.
15. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Cërrik.
16. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
17. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
18. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
Drejtoria e Ligjshmërisë

## **RAPORTI I GJETJEVE**

### **MBI**

### **VEPRIMTARITË ME KARAKTER PUBLIK TË DISA INSTITUCIONEVE, PËR PERIUDHËN 19 – 25 JANAR 2025**

Në lidhje me raportimet e veprimtarive publike në Ndërfaqen e Raportimeve të Institucioneve (NRI), për periudhën 19 janar – 25 janar 2025, konstatohet si vijon:

- **70 institucione** të reja janë regjistruar në NRI,
- **357 raportime** janë kryer **në total**,
- **334** postime janë aktive,
- **23** janë të ndaluara,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u ka kërkuar sqarime disa institucioneve dhe i ka kërkuar marrjen e masave për saktësimin e raportimeve, ose, në të kundërt marrjen e sanksioneve administrative për raportime të paplota, për ato institucione të cilat, gjatë raportimit nuk kanë vendosur të gjithë elementët e nevojshëm dhe të domosdoshëm që mundësojnë monitorimin e tyre.

Për datat **19-25 janar 2025**, në ndërfaqen e raportimeve janë ndaluar **23** veprimtari të raportuara, nga 14 institucione në total si më poshtë vijon:

- **13** institucione për shkak të tejkalimit të afatit ligjor,
- **1** institucion për shkak të tematikës si veprimtari e ndaluar,

**1. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **2** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon:

- Në datën 19.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 23.1.2025, ora 15.00, në njësinë Administrative Nr. 2, me tematikë “Konference/sumit”, “Ekonomi”, “Ambasada izraelite organizon shfaqjen e filmit për Holokaustin, te Teatri i Operës dhe Baletit’.
- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 20.1.2025, ora 10.00, “Event i organizuar në Bruksel, në datë 15-16 janar nga Bashkimi Evropian për Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian, ku u diskutua për marrëdhëniet BE-Shqipëri



*dhe rolin e bizneseve si dhe partnereve sociale dhe të shoqërisë civile, në procesin e integritit të Shqipërisë në BE”.*

**2. Bashkia Roskovec** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon:

➤ Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 10.00, me tematikë “Informim/ndërgjegjësim”, “Çështje sociale”, *“Ftesë për zhvillimin e një trajnimi me teme “Trajnim për një jetë të shëndetshme” e zhvilluar nga ACA – Albania Community Assist. Save the Children po zbaton Projektin e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC): “Shkollat për Shëndetin”.*

**3. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon:

➤ Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 23.1.2025, ora 08.30, me tematikë “Tjetër”, “Çështje sociale”, *“Trajnim i mesimdhënësve të Shkollave të Mesme Profesionale dhe instruktoreve të Qendrave të Formimit Profesional për ofrimin e kurrikulës "Aftësi për Punësim".*

**4. Zyra Vendore Arsimore Elbasan** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon:

➤ Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 11.00, Njësia Administrative Elbasan R1, me tematikë “Informim/ ndërgjegjësim”, *“Të drejtat e njeriut”, “Marshim i Paqes: i përvitshëm, i organizuar nga Qendra e Bashkëpunimit Ndërfetar, me teme: “Mbrojmë Jetën”.*

**5. Bashkia Sarandë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **2** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon:

➤ Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 10.00, Njësia Administrative Sarandë, me tematikë “Inspektim”, “Infrastrukturë”, *“Kryetari i Bashkisë Sarandë z.Oltion Caci së bashku me Drejtorin e Shërbimeve z. Joli Dine dhe specialist të kësaj drejtorie do të inspektojnë rrugë të ndryshme të qytetit për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale’.*

➤ Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 12.00, Njësia Administrative Sarandë, me tematikë “Inspektim”, “Infrastrukturë”, *“Kryetari i Bashkisë Sarandë z.Oltion Caci së bashku me Drejtorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit z. Zenel Bajrami , Drejtorin e shërbimeve z. Joli Dine do të inspektojnë rikonstrukcionin e rrugës "Pandeli Bocari" Sarandë.*

**6. Ministria e Financave** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **3** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon:

➤ Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 22.1.2025, ora 09.30, në njësinë Administrative Nr. 9, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, *“Takimi - Due Diligence për zhvillimin e Eurobondit 2025. Me pjesëmarrjen e Ministrive të*

*ndryshme dhe insitucioneve të tjera, si Banka e Shqipërisë, INSTAT, etj.. Ky proces realizohet ne kuadër të vlerësimit të vendit nga bankat bashkëdrejtuese të procesit të Eurobondit përpara emetimit”.*

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 21.1.2025, ora 16:30, në njësinë Administrative Nr. 9, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, *“Mbledhja periodike e Këshillit Tatimor, mbi diskutime që kanë të bëjnë me përmirësimet e kuadrit ligjor fiskal, aktet dhe udhëzimet. Anëtarët e përhershëm të Këshillit janë përfaqësues nga shoqata dhe dhoma të tregtisë, të cilët diskutojnë në lidhje me rendin e ditës dhe njihen me zhvillimet më të fundit në fushën e çështjeve fiskale”.*
- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 22.1.2025, ora 10:30, në njësinë Administrative Nr. 5, Kryesia e Kuvendit, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, *“Diskutimi ne Komisionin Parlamentar te Ekonomisë mbi Aktin Normativ për disa ndryshime ne Buxhetin 2024.”*

**7. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon:

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 11.00, Njësia Administrative Korçë, me tematikë “Tjetër”, *“Aktivitet për Ditën Ndërkombëtare të Edukimit.*

**8. Korporata e Investimeve Shqiptare** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon:

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 13.00, në njësinë Administrative nr. 5 , me tematikë “Tryezë diskutimesh”, *“Kompania franceze Inetum Consulting po realizon një studim mbi investimet në sektorin digjital në Shqipëri. Ky projekt ka për qëllim zhvillimin e Shqipërisë në strukturimin e strategjisë së saj lidhur me digjitalizimin, duke krijuar njëkohësisht lidhje me kompani dhe investitorë francezë.”*

**9. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon:

- Në datën 21.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 13.00, vendndodhja “Jashtë vendit”, “Manchester”, tematika *“Vizitë studimore nga data 21- 25.01.2025. Në këto ditë do të zhvillohen konferenca për sistemin e burgjeve. Nga Shqipëria janë në këtë vizitë 20 përfaqësues, ndërsa në Manchester do të jenë drejtues të sistemit korrektues në Angli’.*
- Në datën 25.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 25.1.2025, ora 10.00, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, *“Në Lezhë, Sindikata e Policëve të Burgjeve kanë zhvilluar mbledhjen periodike, ku ka qenë i ftuar edhe Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve z. Klevis Qose. Në takim janë diskutuar problemet në sistemin e burgjeve”.*

**10. Banka e Shqipërisë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon:

- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 23.1.2025, ora 09.00, me tematikë, “Tjetër”, “Ekonomi”, “workshop teknik mbi *Aspektet teknike dhe ligjore të anëtarësimit në SEPA. workshopi është zhvilluar në praninë e përfaqësuesve të sistemit bankar dhe institucioneve financiare, pa media. Në media do të publikohet fjala e Zëvendës guvernatores së Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi.*

**11. Bashkia Elbasan** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- Në datën 21.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 22.1.2025, ora 16.00, vendndodhja “Hotel Skampa Lgj "Luigj Gurakuqi”, tematika “*Tryezë diskutimesh*”, “Ekonomi”.

**12. Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **4** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 27.1.2025, ora 10.00, me tematikë, “Tryezë diskutimesh”, “*Takim me kryepleqtë e zonës së Gjinarit*”,
- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 27.1.2025, ora 11.00, me tematikë, “Tjetër”, “Infrastrukturë”, “*Takim me pronaret e bujtinave të zonës së Gjinarit*”,
- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 27.1.2025, ora 12:30, me tematikë, “Tjetër”, “mjedis”, “*Mbjellje pemësh në fshatin Valsh*”,
- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 27.1.2025, ora 13:00, me tematikë, “Tjetër”, “Infrastrukturë”, “*Vizitë në Kishën e Valshit*”
- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 27.1.2025, ora 14:00, me tematikë, “Inspektim”, “Infrastrukturë”, “*Inspektim në punimet e rrugës së Shushicës*,

**13. Bashkia Mat** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- Në datën 24.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 28.1.2025, ora 10:00, me tematikë ‘Inagurim’, “Arsim”, “*Bashkia Mat në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë në muajin qershor 2024 ka nisur investimin për Rikonstruksionin e plotë të qendrës Rinore Mat "Rinovart"*.

**14. Bashkia Cërrik** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari brenda afatit ligjor por referuar tematikës përbën veprimtari të ndaluar sipas parashikimeve të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 28.1.2025, ora 10.00, në njësinë Administrative Cërrik, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, “*Kryetari i Bashkisë Cërrik do të zhvillojë një takim me strukturat e Partisë Socialiste në qytet, ku do të diskutohen çështje të rëndësishme që lidhen me proceset zgjedhore. Në qendër të diskutimeve do të jenë strategjitë për përgatitjen e zgjedhjeve të ardhshme, Një tjetër pikë kyçe e takimit do të jetë vota e diasporës, një element që konsiderohet thelbësor për*

*përfshirjen e plotë të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit në procesin demokratik të vendit. Kryetari synon të bashkëpunojë ngushtë me strukturat lokale për të siguruar që proceset të jenë të organizuara dhe efektive, duke promovuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente.*

KQZ është në monitorim të vazhdueshëm të institucioneve shtetërore të cilat kryejnë raportimet në lidhje me veprimtaritë publike që planifikohen të zhvillohen prej tyre, të paktën 5 ditë para zhvillimit të tyre dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.